EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8335
E mërkurë, 8 korrik 2026
Çmimi 0. 50 €

Trumpi në Ankara për samitin kyç të NATO-s

FAQE 7

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

TERRAS NË PRISHTINË: E ARDHMJA E KOSOVËS NË BE, POR ANËTARËSIMI KËRKON REFORMA

FAQE 3

Raportuesi për Kosovën në Parlamentin Evropian, Riho Terras, ka thënë të martën se e ardhmja e Kosovës është në Bashkimin Evropian, por për anëtarësim në bllok kërkohen reforma. "Po punojmë në këtë drejtim", ka thënë ai pas takimeve që zhvilloi me udhëheqës politikë në Kosovë. Ndërkaq ushtruesja e detyrës së presidentes së Kosovës, Albulena Haxhiu, ka theksuar se aplikimi i Kosovës për anëtarësim në BE duhet të trajtohet pa vonesa të mëtejshme dhe se përparimi i vendit duhet të vlerësohet mbi bazën e meritave

DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS JANË KRIJUAR "PËR ARSYE TË GABUARA, NË MËNYRË TË GABUAR, ME LIGJ TË GABUAR, ME MANDAT TË GABUAR"

F. 7

Jason STEINBAUM *në portalin "Bridges of Memory"*

INCIZIM ZËRI DHE NJOHJE FYTYRASH: ÇFARË KAMERASH BLEJNË INSTITUCIONET PUBLIKE?

F. 4-5

AKTUALE

NGA SIMPOZIUMI SYMI, KURTI: NUK KEMI PËRPLASJE QYTETËRIMESH, POR PËRPLASJE TË NDËRGJEGJES ME REAKSIONIN

F. 5

TESTIN E ARRITSHMËRISË E KALOJNË 48.35 % E NXËNËSVE

F. 6

EKONOMI

DOGANA E KOSOVËS ZBULON MALL KOMERCIAL DHE 29 900 EURO TË PADEKLARUARA NË HAN TË ELEZIT

F. 6

MURATI: KOSOVA PRITET TË JETË NDËR TOP VENDET ME RRITJEN EKONOMIKE MË TË SHPEJTË

F. 6

SPORT

RONALDO LË TË HAPUR MUNDËSINË PËR TË LUAJTUR NË "EURO 2028"

F. 11

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht -Tetovë
Gurëz-Ferizaj
E-mail: renova@mt.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

TRUMPI NË ANKARA PËR SAMITIN KYÇ TË NATO-S

ANKARA, 7 KORRIK - Presidenti amerikan Donald Trump ka arritur të martën në Ankara, ku udhëheqësit e NATO-s po mblidhen për atë që mund të bëhet në një nga samitet më të rëndësishme të aleancës në vitet e fundit - jo sepse pritet të prodhojë ndonjë rezultat dramatik, por sepse mund të përcaktojë se si do të duket NATO pas dekadash të dominimit të udhëheqjes ushtarake amerikane.

Samiti i 7-8 korrikut zhvillohet në një kohë kur Uashingtoni haptazi po i përgatit aleatët evropianë për një ndryshim gradual të pranisë ushtarake amerikane në kontinent, po u bën presion vendeve anëtare t'i rrisin ndjeshëm shpenzimet për mbrojtjen dhe po sinjalizon se siguria e Evropës duhet të bëhet gjithnjë e më shumë përgjegjësi e Evropës.

Trumpi qëndron në Ankara me ankesat e njohura lidhur me atë se shumë aleatë vazhdojnë të përfitojnë nga mbrojtja amerikane, pa kontribuar mjaftueshëm vetë.

Por, pas retorikës publike fshihet një debat shumë më i thellë për të ardhmen e NATO-s: si të ribalancohet aleanca pa dobësuar aftësinë e saj parandaluese ndaj Rusisë.

Zyrtarë të lartë amerikanë konfirmuan para samitit se rishikimi i vazhdueshëm nga Pentagoni i pranisë ushtarake amerikane në Evropë mund të çojë në zvogëlimin e numrit të forcave amerikane, të stacionuara në të gjithë kontinentin. "Nuk duhet të ketë habi që po bëjmë një rishikim të pranisë sonë ushtarake", tha një zyrtar i lartë amerikan. "Ky rishikim mund të çojë fare mirë në përshtatjen e pranisë sonë sepse synojmë t'ia kalojmë Evropës një pjesë më të madhe të barrës".

Një tjetër zyrtar i lartë i tha Radios Evropa e Lirë më 6 korrik se ky rishikim pasqyron "kërkesat globale" ndaj forcave amerikane dhe nguli këmbë se çdo ndryshim në numrin e trupave do të udhëhiqet nga konsideratat strategjike dhe jo politike.

Një samit që do ta masë gatishmërinë e Evropës

Për administratën e Trumpit, samiti në Ankara ka të bëjë më pak me deklaratat dhe më shumë me rezultatet konkrete. Shtëpia e Bardhë kërkon dëshmi se aleatët evropianë po i shndërrojnë premtimet në kapacitete ushtarake. "Ne presim që të gjithë aleatët të tregojnë një trajektore të qartë dhe domethënëse rritjeje si në aspektin sasior ashtu edhe në atë cilësor, të shpenzimeve për mbrojtjen, në mënyrë që barra të ndahet më drejt", u tha gazetarëve para samitit ambasadori i ShBA-së në NATO, Matthew Whitaker. Ai veçoi Poloninë, Gjermaninë dhe vendet nordike e baltike si shembuj të aleatëve që po lëvizin në drejtimin e duhur.

Vetë Trumpi, megjithatë, ka qenë më pak diplomatik. "Isha i zhgënjyer nga Italia. Isha i zhgënjyer nga Mbretëria e Bashkuar... U zhgënjyem nga Gjermania dhe Franca. Spanja është një katastrofë. Spanja është e tmerrshme... Ata mendojnë se po përfitojnë falas", tha Trumpi javën e kaluar gjatë një takimi në Zyrën Ovale me sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Mark Rutte.

Megjithëse ShBA-ja mbetet kontribuuesja më e madhe e NATO-s sa iu përket shpenzimeve, disa aleatë - përfshirë Poloninë, Lituaninë, Letoninë, Estoninë dhe Norvegjinë - tashmë ndajnë një përqindje më të madhe të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) për mbrojtjen sesa Uashingtoni.

Pas zotimeve të marra në samitin e vitit të kaluar në Hagë, vendet anëtare të NATO-s pritet që në Ankara të paraqesin plane konkrete që tregojnë se si synojnë të arrijnë shpenzime për mbrojtjen në nivelin prej 5 për qind të PBB-së deri në vitin 2035.

Matthew Kroenig, ish-këshilltar i posaçëm i Pentagonit për strategjinë dhe politikat e mbrojtjes, vlerësoi se ky samit do të shndërrohet në një "samit i rezultateve".

"Çështja është nëse evropianët po e marrin vërtet përsipër barrën që administrata Trump synon t'u transferojë", tha Kroenig më 6 korrik gjatë një diskutimi në Institutin Brookings.

Edhe pse pranoi se është shënuar përparim, Kroenig tha se zyrtarët amerikanë mbeten të shqetësuar se shumë aleatë ende nuk kanë plane të besueshme për të arritur objektivat e dakorduara të shpenzimeve për mbrojtjen, teksa ende ka pikëpyetje nëse nismat industriale evropiane mund të krijojnë kapacitete që tashmë ofrohen nga prodhuesit amerikanë, në vend që ta forcojnë NATO-n në mënyrën më efikase.

Drejt 'NATO 3.0'

Përtej buxheteve, samiti pasqyron një transformim shumë më të gjerë strategjik. Në vend që ta shpërbëjë NATO-n, shumë analistë besojnë se Uashingtoni po përpiqet ta ridefinojë rolin e aleancës.

Charles Kupchan, bashkëpunëtor i lartë në Këshillin për Marrëdhënie të Jashtme, e përshkroi këtë proces si ribalancim që, sipas tij, është dashur të ndodhte më parë, e jo

një krizë ekzistenciale. "Po kalojmë një periudhë të domosdoshme ribalancimi, ku Evropa po merr më shumë përgjegjësi, ndërsa Shtetet e Bashkuara po rishpërndajnë burimet e tyre dhe po riorganizojnë prioritetet strategjike", tha Kupchan gjatë një diskutimi të organizuar nga Këshilli për Marrëdhënie me Jashtë më 6 korrik.

Teksa disa analistë e përshkruajnë NATO-n si një aleancë që po hyn në një periudhë të pasigurisë strategjike, Kupchan argumentoi se themelet institucionale të aleancës mbeten të paprekura. "Nuk besoj se jemi dëshmitarë të fundit të aleancës transatlantike", tha ai. "Institucioni mbetet i paprekur".

Megjithatë, ai paralajmëroi se qasja e Trumpit ka dëmtuar një nga asetet më të vlefshme strategjike të NATO-s: besimin. "Forca më e madhe e Amerikës janë partneritetet e saj", tha Kupchan. "Në Evropë do të ketë më shumë armë dhe më shumë tanke, por do të përballemi me probleme serioze nëse askush nuk na do".

Liana Fix, një tjetër bashkëpunëtore e lartë në Këshillin për Marrëdhënie me Jashtë, tha se beson që Evropa tani po vepron njëkohësisht në dy realitete strategjike.

Publikisht, udhëheqësit vazhdojnë të flasin për një ndarje më të drejtë të barrës dhe për një NATO më të fuqishme. Privatisht, megjithatë, qeveritë po përgatisin gjithnjë e më shumë plane rezervë në rast se Uashingtoni e redukton më tej angazhimin e tij ushtarak në Evropë. "Amerikanët po tërhiqen më shpejt sesa evropianët janë në gjendje ta mbushin boshllëkun", tha Fix duke paralajmëruar se aleanca mund të përballet me mungesa të konsiderueshme të kapaciteteve, veçanërisht në mbrojtjen ajrore, logjistikën strategjike dhe mbrojtjen raketore. Sipas saj, vetë Ukraina po bëhet një shtyllë gjithnjë e më qendrore e sigurisë së ardhshme të Evropës. "Sa më shumë që ShBA-ja të tërhiqet nga Evropa, aq më shumë Ukraina bëhet një garantuese e sigurisë për Evropën", tha Fix.

Ukraina kërkon përfitime konkrete

Ukraina merr pjesë në samitin në Ankara në një kohë kur po përballet me sulme gjithnjë e më intensive raketore nga Rusia dhe me mungesa në rritje të penguesve të avancuar për mbrojtjen ajrore.

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky pritet të takohet me Trumpin në margjinat e samitit, teksa do t'i përsërisë kërkesat për sisteme shtesë raketore Patriot, pas një tjetër sulmi vdekjeprurës ndaj Kievit.

Tyson Barker, ish-zëvendës i të dërguarit të posaçëm i ShBA-së për rimëkëmbjen ekonomike të Ukrainës, tha se beson që suksesi i Kievit nuk do të matet nga deklaratat politike, por nga zotimet konkrete ushtarake.

"Çdo zotim për më shumë sisteme të mbrojtjes ajrore do të ishte jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe shumë i nevojshëm", i tha Barker Radios Evropa e Lirë më 6 korrik.

Në vend se të përqendrohet te debatet për anëtarësimin e Ukrainës në NATO, Barker tha se samiti duhet t'i japë përparësi rritjes së prodhimit të armatimit, dërgesave të armëve dhe bashkëpunimit në industrinë e mbrojtjes. "Nuk besoj se mesazhet politike për raportet në të ardhmen mes NATO-s dhe Kievit mund të sjellin ndonjë rezultat pozitiv në këtë moment", tha ai. "Nevojat urgjente janë zotimet më të mëdha për furnizimin me armë, veçanërisht sisteme të mbrojtjes ajrore, si dhe bashkëpunim më i ngushtë në prodhimin e pajisjeve të mbrojtjes".

Barker, po ashtu, sugjeroi se Ankaraja mund të forcojë më shumë dinamikën në zhvillim të bashkëpunimit në rajonin e Detit të Zi midis Turqisë dhe Ukrainës përmes zgjerimit të bashkëpunimit në industrinë e mbrojtjes.

Kroenig vuri në pah se, pavarësisht prej kritikave nga Evropa, administrata e Trumpit argumenton se vazhdon ta mbështesë Ukrainën përmes ndarjes së informacioneve të inteligjencës, zgjerimit të autorizimit për goditje thellë brenda territorit rus dhe lehtësimit të blerjes nga Evropa të armëve amerikane. Megjithatë, ai pranoi se penguesit për sistemin Patriot mbeten ndër kapacitetet ushtarake më të rralla në botë.

"Nuk e di nëse ShBA-ja mund ose do të bëjë diçka më shumë", tha Kroenig. "Ky është një nga kapacitetet për të cilat kërkesa është jashtëzakonisht e lartë, ndërsa furnizimi mbetet shumë i ulët".

Lindja e Mesme zgjeron agjendën e NATO-s

Megjithëse Ukraina dominon agjendën e sigurisë, samiti në Ankara do të vë në pah edhe vëmendjen në rritje të NATO-s ndaj Lindjes së Mesme.

Zyrtarë të lartë të administratës amerikane i thanë Radios Evropa e Lirë se presidenti Trump dëshiron që aleatët të marrin më shumë përgjegjësi për mbrojtjen e transportit tregtar detar përmes Ngushticës së Hormuzit, pas paqëndrueshmërisë së fundit në rajon. Barker paralajmëroi se qeveritë evropiane kanë sinjalizuar tashmë gatishmërinë për të kontribuar në sigurinë detare vetëm pasi situata të stabilizohet dhe të ketë një armëpushim të qëndrueshëm.

Vendndodhja e samitit në Ankara po ashtu thekson rëndësinë gjithnjë e më të madhe gjeopolitike të Turqisë.

Trumpi pritet të zhvillojë takime dypalëshe me presidentin turk Recep Tayyip Erdoaan, Zelenskyn si dhe presidentin sirian Ahmed al-Sharaa. Këto takime pasqyrojnë angazhimin e ripërtërirë diplomatik të Uashingtonit në rajon pas muajsh të tensioneve të rritura.

Ekspertët e Këshillit për Marrëdhënie me Jashtë argumentojnë se roli i Turqisë brenda NATO-s po nxitet gjithnjë e më pak nga siguria evropiane dhe gjithnjë e më shumë nga rëndësia e saj strategjike në Siri, Mesdheun Lindor dhe në Lindjen e Mesme në tërësi.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

TERRAS NË PRISHTINË: E ARDHMJA E KOSOVËS NË BE, POR ANËTARËSIMI KËRKON REFORMA

Raportuesi për Kosovën në Parlamentin Evropian, Riho Terras, ka thënë të martën se e ardhmja e Kosovës është në Bashkimin Evropian, por për anëtarësim në bllok kërkohen reforma. "Po punojmë në këtë drejtim", ka thënë ai pas takimeve që zhvilloi me udhëheqës politikë në Kosovë. Ndërkaq ushtruesja e detyrës së presidentes së Kosovës, Albulena Haxhiu, ka theksuar se aplikimi i Kosovës për anëtarësim në BE duhet të trajtohet pa vonesa të mëtejshme dhe se përparimi i vendit duhet të vlerësohet mbi bazën e meritave

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 KORRIK - Ushtruesja e detyrës së presidentes së Republikës së Kosovës, Albulena Haxhiu, ka pritur të martën në takim eurodeputetin Riho Terras, raportues i përhershëm i Parlamentit Evropian për Kosovën.

Haxhiu e falënderoi Terrasin për angazhimin dhe mbështetjen e tij ndaj perspektivës evropiane të Kosovës. Ajo theksoi se aplikimi i Kosovës për anëtarësim në Bashkimin Evropian duhet të trajtohet pa vonesa të mëtejshme dhe se përparimi i vendit duhet të vlerësohet mbi bazën e meritave.

Sipas u.d. presidentes, Kosova nuk kërkon përjashtim nga kriteret, por një proces të drejtë, i cili do t'i hapte rrugën marrjes së statusit të vendit kandidat dhe fillimit të negociatave për anëtarësim.

Haxhiu paraqiti përparimin e Kosovës në reformat evropiane, sundimin e ligjit dhe zhvillimin ekonomik, si dhe bashkëpunimin e ngushtë me institucionet e Bashkimit Evropian. Ajo vuri në pah se orientimi euroatlantik i Kosovës është i qartë, i qëndrueshëm dhe gëzon mbështetje të gjerë qytetare.

U.d. presidentja foli edhe për dialogun me Serbinë, çështjet e sigurisë dhe mungesën e përgjegjësisë për sulmin terrorist në Banjskë. Ajo theksoi se procesi evropian duhet të mbështetet në zbatimin e marrëveshjeve dhe në përgjegjësi të barabartë për të gjitha palët.

Raportuesi për Kosovën në Parlamentin Evropian, Riho Terras, tha se e ardhmja e Prishtinës është në Bashkimin Evropian, por për anëtarësim në bllok kërkohen reforma. "Po punojmë në këtë drejtim", tha ai në një postim në X pasi zhvilloi takime me udhëheqës politikë në Kosovë.

Gjatë qëndrimit në Kosovë, eurodeputeti Terras u takua edhe me ministrin në detyrë i Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Glauk Konjufca, e vlerësoi rolin e Parlamentit Evropian në mbështetjen e aspiratave të Kosovës.

Në takim u diskutua për zhvillimet politike në vend, formimin e institucioneve të reja pas zgjedhjeve parlamentare, si dhe për procesin e integrimit evropian dhe euroatlantik të Republikës së Kosovës.

Zëvendëskryeministri Konjufca vlerësoi rolin e Parlamentit Evropian në mbështetjen e aspiratave evropiane të Kosovës dhe e falënderoi Terrasin për angazhimin e tij

në raport me zhvillimet në vendin tonë.

Në këtë drejtim, ai theksoi rëndësinë që aplikimi i Kosovës për anëtarësim në Bashkimin Evropian ta marrë vëmendjen e merituar, duke i hapur rrugë avancimit drejt statusit të vendit kandidat dhe negociatave për anëtarësim.

Konjufca tha se Republika e Kosovës mbetet e angazhuar maksimalisht për avancimin e rrugës evropiane, thellimin e bashkëpunimit me institucionet e Bashkimit Evropian dhe përmbushjen e hapave të nevojshëm drejt integrimit të plotë në BE.

Eurodeputeti gjatë qëndrimit në Prishtinë zhvilloi takim edhe me kreun e Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza.

PDK-ja në një komunikatë për medie ka theksuar se gjatë takimit u diskutua për zhvillimet politike në vend, procesin e integrimit evropian dhe domosdoshmërinë e tejkalimit të ngërçit institucional.

Hamza e falënderoi raportuesin Riho Terras për angazhimin e tij të vazhdueshëm dhe për raportin e fundit të Parlamentit Evropian për Kosovën, duke vlerësuar konfirmimin se e ardhmja e Kosovës është në Bashkimin Evropian si dhe mbështetjen për aplikimin e Kosovës për anëtarësim.

Kryetari Hamza dhe eurodeputeti Terras vlerësuan se raporti i Parlamentit Evropian është një mesazh i rëndësishëm mbështetjeje për Kosovën, njëkohësisht edhe një thirrje që vendi të mos humbasë më kohë për shkak të krizave të brendshme politike dhe vonesave në funksionalizimin e institucioneve.

Kryetari Hamza theksoi se Partia Demokratike e Kosovës ndan shqetësimin e shprehur në raport lidhur me pamundësinë e krijimit të institucioneve plotësisht funksionale për një periudhë të gjatë. Ai theksoi se Kosovës i nevojiten institucione funksionale që marrin vendime, zbatojnë reforma dhe rindërtojnë besimin me partnerët ndërkombëtarë. "Stabiliteti nuk duhet të nënkuptojë vetëm formimin e institucioneve, por edhe qeverisjen demokratike, dialogun politik dhe respektimin e Kushtetutës", tha Hamza.

Kryetari i PDK-së, Bedri Hamza, shprehu mirënjohjen për rolin e eurodeputetit Riho Terras dhe të Parlamentit Evropian si mbështetës të fuqishëm të Kosovës dhe të aspiratave tona për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Vizita e raportuesit të përhershëm për Kosovën në PE vjen pasi në mesin e muajit qershor, PE-ja miratoi rezolutën vjetore për Kosovën. Pas miratimit të rezolutës, Terras tha se reformat dhe përparimi në dialogun Kosovë - Serbi, që ndërmjetësohet nga blloku, mbeten kyçe në rrugën evropiane të Kosovës.

INCIZIM ZËRI DHE NJOHJE FYTYRASH: ÇFARË KAMERASH BLEJNË INSTITUCIONET PUBLIKE?

Disa institucione publike shëndetësore, komunale dhe arsimore në Kosovë kanë blerë ose kanë kërkuar të blejnë sisteme kamerash me funksione të incizimit të zërit dhe njohjes së fytyrës. Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP) thotë se përdorimi i këtyre teknologjive, në parim, është i ndaluar dhe duhet të jetë përjashtim, jo rregull. Ekspertët paralajmërojnë se përdorimi i tyre mund ta cenojë privatësinë, sidomos kur kamerat vendosen në spitale, shkolla, çerdhe dhe hapësira publike

Prishtinë, 7 korrik - Gjithçka filloi me një diskutim brenda stafit në Spitalin e Përgjithshëm të Ferizajt. Në muajt e parë të vitit 2026 ky spital kishte ndërruar kamerat e sigurisë për disa më të reja. "Ka pasur fjalë se janë vendosur kamera me zë", thotë për Radion Evropa e Lirë Sadat Haxhiu, teknik i Radiologjisë në këtë spital.

Haxhiu, i cili është edhe kryesues i Federatës së Sindikatës së Punëtorëve Shëndetësorë për rajonin e Ferizajt, thotë se me t'i dëgjuar këto fjalë, vendosi të reagojë. "E kam njoftuar Federatën në nivel qendror. Ka intervenuar tek Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave (Agjencia për Informim dhe Privatësi)", thotë ai.

Një ankesë për këtë çështje kishte arritur në Agjencinë për Informim dhe Privatësi (AIP) qysh më 9 mars.

Agjencia, më pas, nisi inspektimin dhe konstatoi se ankesa ishte e bazuar.

Më 27 prill AIP e urdhëroi spitalin që ta ndalojë vëzhgimin e këtij lloji.

Haxhiu konfirmon për REL-in se urdhri ka funksionuar dhe se kamerat që incizonin zërin, janë hequr.

Pse u vendosën këto kamera?

Deri në publikimin e këtij artikulli, udhëheqja e spitalit nuk iu përgjigj pyetjeve të Radios Evropa e Lirë lidhur me arsyet e vendosjes së kamerave me aftësi për incizimin e zërit.

Vetë Haxhiu thotë se nuk beson që ka pasur ndonjë qëllim të keq të menaxhmentit. "Nuk ma merr mendja edhe që i ka dëgjuar dikush ata (zërat nga kamerat). Edhe drejtoria... s'besoj që e ka ditur që janë me zë ato kamera", thotë ai.

Por, sipas të dhënave publike të prokurimit, aftësia e incizimit të zërit ishte kriter specifik i kërkuar në dosjen e tenderit, që u dha në nëntor të vitit 2025.

Në këtë dosje, ku ishte kërkuar blerja e 32 kamerave, specifikohej se duhet pasur "1 ch Audio In/Out" - një kanal që ofron komunikim me zë në të dyja anët.

Spitali i Ferizajt nuk iu përgjigj as pyetjeve për arsyet e kërkimit të kësaj specifike, e as se si u zëvendësuan më pas kamerat, pasi u hoqën ato me funksion të incizimit të zërit.

A lejohet incizimi i zërit nga kamerat e sigurisë?

Sipas Agjencisë për Informim dhe Privatësi, shumë rrallë. "Duke qenë se teknologjitë e njohjes së fytyrës dhe audio-incizimi paraqesin forma veçanërisht invazive (ndërhyrëse) të përpunimit të të dhënave personale, përdorimi i tyre duhet të konsiderohet përjashtim dhe jo rregull", thanë nga kjo agjenci për Radion Evropa e Lirë.

Agjencia vlerësoi, po ashtu, se ky lloj përpunimi i të dhënave paraqet "një ndërhyrje të thellë në privatësinë e individëve" dhe se "nuk duhet të konsiderohet pjesë e zakonshme e sistemeve të vëzhgimit me kamerë".

Kamera të avancuara në spitale, shkolla e rrugë?

Spitali i Ferizajt nuk është institucioni i vetëm që, të paktën në kërkesat për blerje të kamerave, ka kërkuar specifika teknike për incizim zëri.

Radio Evropa e Lirë analizoi dosjet e tenderëve të hapur në vitet e fundit për blerjen e sistemeve të kamerave dhe, në të paktën 10 prej tyre, specifikat teknike parashihnin edhe funksionin e audios.

Për më tepër, në disa prej tyre, u kërkua edhe "njohja e fytyrave" dhe aftësia për "analiza inteligjente".

Një nga këta tenderë u dha nga komuna e Drenasit në tetor të vitit 2025 për kamera që tashmë janë instaluar në disa rrugë të kësaj komune.

Në përgjigjen për Radion Evropa e Lirë, kjo komunë tha se, megjithëse kamerat e instaluara kanë mundësi teknike për incizim audio dhe video, aktualisht është aktivizuar vetëm mundësia e regjistrimit të videos. Ajo sqaroi, po ashtu, se disa nga kamerat kanë aftësitë e njohjes së targave të automjeteve, "me qëllim identifikimin e automjeteve të dyshimta ose të automjeteve që kryejnë shkelje të rregullave të komunikacionit në rrugët e qendrës së qytetit".

Komuna nuk dha sqarime se çfarë nënkuptonin konkretisht specifikat e kërkuara në dosjen e tenderit, përfshirë ato për "të mësuarit e thellë për klasifikimin e njerëzve dhe automjeteve", si dhe për "njohjen e maksimum 50 fytyrave në hapësira publike".

Kërkesë për kamera në shkolla dhe çerdhe

Rreth 50 kilometra larg Drenasit, edhe komuna e Mitrovicës së Jugut përgatiti një tender të ri. Në këtë tender që u hap më 18 qershor dhe është ende në fazë fillestare, kërkohen të blihen kamera për disa institucione arsimore, përfshirë shkolla e çerdhe.

Në specifikat e këtij tenderi, ndër të tjera, kërkohet që sistemi i kamerave të ketë "hyrje dhe dalje audio për komunikim [të dyanshëm]".

Veç kësaj, sipas komunës, ky sistem duhet të mbështesë deri në 300 baza të të dhënave të fytyrave (ose ekuivalentin e tyre)

→

NGA SIMPOZIUMI SYMI, KURTI: NUK KEMI PËRPLASJE QYTETËRIMESH, POR PËRPLASJE TË NDËRGJEGJES ME REAKSIONIN

PRISHTINË, 7 KORRIK - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka shkruar për pjesëmarrjen e tij në edicionin e 28 të Simpoziumit SYMI, i cili po mbahet në Greqi me temën "Achilles' Wrath and Cassandra's Warning - Empowering Democracy and Taming Power" (Zemërimi i Akilit dhe paralajmërimi i Kasandrës - Fuqizimi i demokracisë dhe zbutja e pushtetit). "Diplomatë të shquar e aktivistë progresistë, zyrtarë shtetesh e akademikë intelektualë, drejtues të organizatave ndërkombëtare e studiues të instituteve kërkimore, diskutojnë së bashku sipas modelit Chatham House Rule për tema të ndryshme të aktualitetit (gjeo)politik global, nga paqja e siguria teksa forcohet mulipolariteti dhe dobësohet multilateralizmi te sulmet e shtuara mbi demokracinë dhe të drejtat e njeriut, nga krizat e shumëfishta e luftërat e reja pa përfunduar të vjetrat te pritjet dhe efektet e inteligjencës artificiale", ka shkruar Kurti në "Facebook".

Ai ka bërë me dije se ka marrë pjesë në panelin "Frontline democracies - The Balkans, Ukraine and more: What complacent older democracies must learn from societies still fighting, every day, for democratic European space." (Demokracitë në vijën e parë të frontit - Ballkani, Ukraina dhe më shumë: Çfarë duhet të mësojnë demokracitë e vjetra të vetëkënaqura nga shoqëritë që ende luftojnë, çdo ditë, për hapësirë demokratike evropiane). "Përveç të tjerash, aty theksova që: - Evropa fillon në shtëpi për secilin shtet dhe përfundon në vijat e frontit të luftës në Ukrainë, dhe se pikërisht zgjerimi i mëtejshëm i Bashkimit Evropian dëshmon që periferia nuk është aty për t'u grabitur. - Në zhvillimet botërore realisht nuk kemi përplasje të jashtme të civilizimeve por sot jetojmë në kohërat e përplasjeve të brendshme të ndërgjegjes me reaksionin. - Autokratët duhen konsideruar si njerëz të lindur në shekullin e gabuar dhe se tendencat paramoderne për monarki merkantiliste nuk mund të triumfojnë mbi republikën demokratike", ka njoftuar Kurti.

KOMF-i: REZULTATET E TESTIT TË ARRITSHMËRISË TREGOJNË MUNGESË TË PËRPARIMIT NË CILËSINË E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR NË KOSOVË

PRISHTINË, 7 KORRIK - Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve KOMF ka theksuar se rezultatet e Testit të Arritshmërisë tregojnë mungesë të përparimit në cilësinë e arsimit parauniversitar në Kosovë. "Rezultatet e Testit të Arritshmërisë janë një tregues i gjendjes së sistemit arsimor dhe duhet të shërbejnë si alarm për të gjitha institucionet përgjegjëse që të ndërmarrin masa konkrete dhe të menjëhershme për përmirësimin e cilësisë së arsimit. Arritshmëria mesatare e nxënësve këtë vit prej vetëm 48.35 %, konfirmon se edhe pas disa vitesh përpjekjesh, sistemi arsimor nuk ka arritur të shënojë përmirësim të qëndrueshëm. Rezultatet tregojnë se dy vitet e fundit nuk është arritur të tejkalohet niveli prej 50 %, duke reflektuar regres në rezultatet e nxënësve (2022: 50.75 %; 2023: 52.1 %; 2024: 52.1 %; 2025: 48.8 %; 2026: 48.35 %). Rezultatet tregojnë se nxënësit mesatarisht arrijnë më pak se gjysmën e kërkesave të testit, duke ngritur shqetësime serioze për përvetësimin e njohurive dhe kompetencave të parapara me kurrikulat arsimore. Kjo situatë paraqet qartë nevojën për një analizë të thelluar të faktorëve që ndikojnë në cilësinë e arsimit, si dhe për ndërmarrjen e veprimeve dhe masave të bazuara në evidencë për përmirësimin e rezultateve të nxënësve", është thënë në reagimin e KOMF-it, duke shtuar se rezultatet nuk paraqesin dallime të rëndësishme ndërmjet komunave, shkollave dhe kategorive të ndryshme të nxënësve. Këto pabarazi tregojnë nevojën për politika më të targetuara, të cilat adresojnë nevojat specifike të shkollave dhe nxënësve që kanë performancë më të ulët", ka theksuar KOMF-i. Sipas këtij



koalicioni, arsimi parauniversitar në Kosovë po përballet me sfida dhe probleme të shumta që ndikojnë negativisht në cilësinë e arsimit.

dhe deri në 100 000 imazhe për njohjen e fytyrës (face recognition).

Deri në publikimin e këtij artikulli, komuna nuk u përgjigj në pyetjet e Radios Evropa e Lirë se pse po kërkonte blerjen e kamerave me këto specifika.

Pse mund të jenë të rrezikshme kamerat inteligjente?

Eksperti i sigurisë kibernetike, Korab Keqekolla, vlerëson se përfshirja e funksioneve si njohja e fytyrës dhe incizimi i zërit në kamerat që prokurojnë institucionet publike, kërkon bazë të qartë ligjore dhe transparencë. "Ka dallim të madh mes një kamere që dokumenton një ngjarje sigurie dhe një sistemi që identifikon njerëz në kohë reale... E para është mbikëqyrje klasike, e dyta është mbikëqyrje biometrike masive", thotë ai për Radion Evropa e Lirë. Sipas tij, njohja e fytyrës mund të përdoret vetëm në raste të kufizuara, si kontrolli i qasjes në zona të ndjeshme, dhe vetëm duke respektuar kërkesat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. "Kur këto sisteme futen në një shkollë a spital pa këtë proces... kalojmë nga siguria fizike te mbikëqyrja e përgjithshme e qytetarëve", thotë Keqekolla.

Ai paralajmëron se edhe incizimi i zërit në spitale mund ta cenojë privatësinë e pacientëve. Përveç kësaj, ai ngre shqetësime edhe për sigurinë kibernetike të këtyre sistemeve. "Kamerat IP janë kompjuterë të lidhur në rrjet, jo pajisje pasive", thotë ai. Sipas Keqekollës, institucionet publike duhet ta kuptojnë që një sistem kamerash nuk është thjesht prokurim i pajisjeve, por "angazhim afatgjatë për të mbrojtur të dhëna të ndjeshme të qytetarëve për vite me radhë". "Nëse nuk kemi kapacitete për këtë përgjegjësi, atëherë as sistemet nuk duhet t'i kenë këto funksione. Fillimi me funksione minimale dhe rritja graduale, aty ku ka nevojë reale dhe kornizë ligjore të qartë, është qasje shumë më e shëndoshë sesa blerja e 'smart' gjithçkaje... sepse është e disponueshme në katalog", shton ai.

Radio Evropa e Lirë identifikoi edhe disa tenderë të ngjashëm në disa institucione të tjera, përfshirë Qendrën e Shëndetit Mendor në Pejë, Qendrën Klinike Stomatologjike në Prishtinë, Komunën e Vushtrrisë, atë të Junikut, Gjilanit e Rahovecit.

Në këta tenderë për blerje të kamerave - disa tashmë të kontraktuar e disa në proces - u kërkuan specifika qoftë për incizimin e zërit, apo edhe analiza inteligjente dhe njohje të fytyrës.

Shumica prej këtyre institucioneve, deri në publikimin e këtij artikulli, nuk iu përgjigjën kërkesës së Radios Evropa e Lirë për koment.

Komuna e Vushtrrisë tha se tenderi, që është në fazë fillestare, i ka specifikat e caktuara meqë furnizimi do të bëhet për Stacionin Policor në Vushtrri.

Megjithatë, në dosjen e tenderit është paraparë edhe furnizimi për qendra shëndetësore dhe objekte shkollore. Edhe për këto objekte kërkohen funksione inteligjente, përfshirë zbulimin dhe krahasimin e fytyrës.

E pyetur pse këto funksione janë paraparë edhe për shkolla dhe institucione shëndetësore, komuna tha se synimi është forcimi i sigurisë në objektet publike ku qarkullon një numër i madh qytetarësh dhe ku ruhen pajisje mjekësore, dokumentacion dhe inventar me vlerë.

"Objektet e QKMF/QMF dhe shkollat kanë qenë në të kaluarën objekt i vjedhjeve, dëmtimeve dhe hyrjeve të paautorizuara jashtë orarit të punës", thuhet në përgjigje.

Sipas komunës, funksioni i zbulimit të fytyrës ndihmon edhe në uljen e alarmeve të rreme, pasi dallon ndërhyrjet njerëzore nga lëvizjet e tjera.

Komuna shtoi se sistemi nuk është i destinuar për mbikëqyrjen e nxënësve gjatë mësimit apo të pacientëve gjatë trajtimit. "Kamerat vendosen në hyrje-dalje, korridore dhe perimetër të jashtëm të objekteve, dhe jo në klasa apo dhoma të ekzaminimit", sipas Komunës së Vushtrrisë.

Komuna e Rahovecit, e cila më 17 qershor 2026 hapi një tender për furnizim me kamera për objekte publike, kërkoi që disa prej tyre të kenë mikrofon të integruar, por nuk sqaroi arsyen e kësaj kërkese.

Në përgjigje, ajo i tha REL-it se "procedura nuk ka përfunduar ende" dhe "nuk është lidhur kontratë me operator ekonomik".

Testin e Arritshmërisë e kalojnë 48.35 % e nxënësve

Prishtinë, 7 korrik - Ministria e Arsimit dhe Shkencës njofton se është përmbyllur procesi i përpunimit të rezultateve të Testit të Arritshmërisë 2026. Në këtë test morën pjesë 21 982 nxënës, ndërsa arritshmëria mesatare e përgjithshme në nivel vendi është 48.35 %.

Analiza e rezultateve sipas lëndëve tregon se arritshmëria më e lartë është shënuar në Gjuhën angleze 65.97 %, Histori 62.23 % dhe Gjuhë shqipe 54.63 %.

Ndërkaq, arritshmëria më e ulët është evidentuar në Kimi 37.68 % dhe Matematikë 37.93 %, pasuar nga Biologjia 40.83 %, Fizika 45.33 %, Informatika 47.87 % dhe Gjeografia 47.84 %.

Rezultatet e Testit të Arritshmërisë ofrojnë një pasqyrë të nivelit të përvetësimit të kompetencave nga nxënësit në përfundim të arsimit të mesëm të ulët dhe do të shërbejnë si bazë për identifikimin e prioriteteve dhe planifikimin e masave në përmirësimin e cilësisë në arsim.

DOGANA E KOSOVËS ZBULON MALL KOMERCIAL DHE 29 900 EURO TË PADEKLARUARA NË HAN TË ELEZIT

Prishtinë, 7 korrik - Gjatë kontrolleve rutinore në hyrje të Republikës së Kosovës, zyrtarët doganorë në Pikën e Kalimit Kufitar Hani i Elezit kanë zbuluar mall komercial dhe mjete monetare të padeklaruara.

Automjeti me targa të Maqedonisë së Veriut është përzgjedhur për kontroll nga zyrtarët doganorë, bazuar në analizën e riskut dhe procedurat standarde të kontrollit.

Gjatë intervistimit fillestar, drejtuesi i automjetit ka deklaruar se nuk kishte asnjë mall apo mjet monetar për deklarim. Megjithatë, gjatë kontrollit fizik të automjetit është konstatuar një sasi malli me natyrë komerciale, e cila nuk ishte deklaruar pranë autoriteteve doganore. Po ashtu, gjatë kontrollit të drejtuesit të automjetit dhe pasagjerit janë gjetur 29 900 euro në para të gatshme, të cilat gjithashtu nuk ishin deklaruar.

Në përputhje me Ligjin nr. 08/L-247 - Kodi Doganor dhe i Akcizave i Republikës së Kosovës, çdo person ka detyrim ligjor t'i deklarojë mallrat që u nënshtrohen procedurave doganore, ndërsa mosdeklarimi përbën kundërvajtje doganore dhe u nënshtrohet masave administrative dhe ndëshkuese të parapara me ligj.

Gjithashtu, bazuar në legjislacionin në fuqi për kontrollin e transportit ndërkufitar të parave të gatshme, çdo person që hyn ose del nga Republika e Kosovës me 10 000 euro ose më shumë, ose kundërvlerën e tyre

në valuta të tjera apo instrumente të negociueshme, është i obliguar t'i deklarojë ato tek autoritetet doganore.

Mosdeklarimi i mjeteve monetare përbën shkelje ligjore dhe sjell masa administrative, përfshirë konfiskimin e përkohshëm të mjeteve monetare dhe zhvillimin e procedurave përkatëse.

Në këtë rast, malli i padeklaruar, mjetet monetare dhe automjeti janë sekuestruar për zhvillimin e procedurave të mëtejshme ligjore.

Në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ndaj palës do të ndërmerren masat e parapara, përfshirë konfiskimin e përqindjes së mjeteve monetare sipas vendimit të autoritetit kompetent dhe procedurat për kundërvajtje doganore.

Dogana e Kosovës ka theksuar se mbetet e përkushtuar për zbatimin e ligjit, mbrojtjen e kufijve doganorë të Republikës së Kosovës, luftimin e tregtisë së paligjshme, kontrabandës dhe parandalimin e pastrimit të parave, duke garantuar sigurinë ekonomike dhe respektimin e legjislacionit në fuqi.

LATIFI KËRKON RIFILLIMIN E PUNIMEVE NË PARKUN INDUSTRIAL MBI OPTERUSHË: ZHVILLIMI EKONOMIK NUK MUND TË MBAHET PENG

Rahovec, 7 korrik - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka kërkuar rifillimin urgjent të punimeve në Zonën Ekonomike - Parkun Industrial mbi Opterushë, duke theksuar se projekti është jetik për zhvillimin ekonomik të komunës. Sipas tij, kërkesa është e qartë: të rifillojnë punimet në sipërfaqen prej 34.89 hektarësh të Parkut Industrial ose kompetencat për realizimin e projektit t'i kalohen Komunës së Rahovecit.

Latifi theksoi se bizneset e Rahovecit kanë nevojë për hapësirë dhe mbështetje për t'u zgjeruar, për të investuar dhe për të krijuar vende të reja pune. "E përsërisim: urgjentisht, duam veprime konkrete. Boll më me vonesa, sepse zhvillimi ekonomik nuk mund të mbahet peng pafundësisht", ka shkruar Latifi në "Facebook".

FILLUAN PUNIMET NË PROJEKTIN TREMILIONËSH INFRASTRUKTUROR NË SHALË

Mitrovicë, 7 korrik - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Faton Peci, së bashku me nënkryetarin Enis Osmani dhe drejtorin për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë, Naser Muja, vizituan nga afër fillimin e punimeve të projektit infrastrukturor në vlerë prej 3 milionë eurosh në lagjen e heroit Mehë Uka në Bajgorë.

Kryetari Faton Peci tha se ky projekt do ta përfshijë asfaltimin e disa rrugëve në fshatrat e kësaj zone. "Investimet e tjera do të vazhdojnë, sepse Shala e meriton zhvillimin", u shpreh kryetari Peci.

Murati: Kosova pritet të jetë ndër top vendet me rritjen ekonomike më të shpejtë

Prishtinë, 7 korrik - Ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati, ka bërë me dije se Kosova pritet të jetë ndër vendet me rritjen më të shpejtë ekonomike gjatë viteve të ardhshme, duke iu referuar një artikulli të publikuar nga "Euronews" mbi parashikimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN).

Në rrjetet sociale, Murati tha se "Euronews" ka publikuar një analizë ku, sipas projeksioneve të FMN-së, Kosova renditet ndër ekonomitë me perspektivën më të mirë të rritjes. "'Euronews' sot ka publikuar një artikull ku tregon se sipas FMN-së, Kosova pritet të jetë ndër top vendet me rritjen ekonomike më të shpejtë gjatë viteve të ardhshme", ka shkruar Murati në "Facebook".



DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS JANË KRIJUAR 'PËR ARSYE TË GABUARA, NË MËNYRË TË GABUAR, ME LIGJ TË GABUAR, ME MANDAT TË GABUAR'

JASON STEINBAUM

Prishtinë, 7 korrik - Si i hodhi poshtë CIA akuzat për tregti organesh para Kongresit amerikan? Si u bë që Administrata e Presidentit Obama ta ndryshon qëndrimin rreth Gjykatës Speciale, si një koncesion politik ndaj përfshirjes së Rusisë në marrëveshje me Iranin rreth armëve bërthamore? Si filloi presioni amerikan ndaj lidershipit kosovar për aprovim të Gjykatës Speciale? Si u pendua kongresmeni Engel që mori pjesë në presionin diplomatik ndaj Hashim Thaçit për krijimin e Gjykatës?

Një opinion i fundit mbi Dhomat e Specializuara të Kosovës jep informata ekskluzive rreth historisë dhe mënyrës së krijimit, mandatit dhe legjitimitetit të kësaj gjykate ndërkombëtare me seli në Hagë.

Autor i shkrimit të botuar në portalin "Bridges of Memory", dedikuar drejtësisë tranzicionale dhe historisë, është Jason Steinbaum, ish-drejtor i stafit pranë Komisionit për Punë të Jashtme në Kongresin amerikan, i cili për 30 vjet rresht ishte edhe shef i stafit të kongresmenit Eliot Engel dhe, si i tillë, njohës i thellë i të gjitha proceseve që përfshinë interesat amerikane në Ballkan, por edhe ato shqiptare në Washington DC.

Autori në këtë shkrim argumenton se gjykata është produkt i presionit politik kryesisht amerikan dhe jo i një procesi të brendshëm të drejtësisë në Kosovë, dhe se struktura e saj përbën një devijim të thellë nga nevojat për drejtësi, por edhe pronësisë institucionale të Kosovës.

Steinabum, që njëherësh është edhe profesor në American University në Washington DC, thotë se qëndrimi fillestar i qeverive amerikane rreth pretendimeve për krime lufte nga UÇK ishte se ato ishin minimale: "Qeveria e Shteteve të Bashkuara i shihte si minimale vazhdimisht akuzat kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), forcës kryengritëse që luftoi për pavarësinë e Kosovës gjatë luftës së viteve 1998-1999. Zyrtarët amerikanë në përgjithësi pranonin se asnjë ushtri nuk është e përsosur, veçanërisht në mjegullën e luftës, por këmbëngulnin se, në tërësi, UÇK-ja ishte sjellë në mënyrë të arsyeshme."

Stainbaum thotë se edhe akuzat më serioze si ato për terrorizëm apo trafikim organe "ishin hedhur poshtë në një raport të CIA-s, të hartuar si përgjigje ndaj një amendamenti të kongresistit Eliot L. Engel, një mbështetës i vendosur i Kosovës, i cili më vonë u bë kryetar i Komitetit për Punë të Jashtme të Dhomës së Përfaqësuesve."

Në shkrimin e tij autorial të botuar sot si përgjigje në një dialog me ish-ministrin e Punëve të Jashtme Petrit Selimin, Jason Steinbaum po ashtu shpjegon edhe detajet e paditura deri më tani për ndërveprimin e Departamentit të Shtetit dhe Ambasadës Amerikane me kongresistin Engel, për të bërë presion ndaj Kosovës. Steinbaum rikujton se "për disa vjet me radhë, Departamenti Amerikan i Shtetit u dha pak ose aspak besueshmëri pretendimeve të Martyt, edhe pas rezolutës së Këshillit të Evropës. Pastaj, pothuajse brenda natës, Shtetet e Bashkuara ndryshuan qëndrim. Diplomatët amerikanë kaluan nga shpërfillja e raportit të Martyt në këmbënguljen, në vitin 2015, se nevojitej një gjykatë ndërkombëtare për t'i hetuar akuzat e tij. "Kërcënimi kryesor ndaj Kosovës u bë se nëse Kosova nuk do të bënte gjykatë, këtë do ta themelonte OKB-ja", sipas Steinbaum: "Nëse Kosova nuk do ta krijonte Gjykatën, paralajmëronin diplomatët amerikanë, ajo do të krijohej nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së - edhe pse, natyrisht, kjo nuk mund të ndodhte nëse ShBA-ja do ta përdorte veton e saj. Më e rëndësishmja, Kosovës iu tha se duhej të vepronte pa vonesë, sepse Shtetet e Bashkuara, aleati i saj më i fortë dhe më i qëndrueshëm, po i kërkonin - lexo: po i impononin - ta bënte këtë".

Këtu Steinbaum jep kontekstin dhe arsyen e këtij ndryshimi të qëndrimit amerikan: "një superfuqi si ShBA ka shumë interesa globale dhe nganjëherë ato interesa përplasen me njëra-tjetrën. Ndërsa akuzat e Martyt zienin në Evropë dhe shpërfilleshin kryesisht nga Uashingtoni, administrata Obama po ndiqte prioritetin e saj kryesor në politikën ndërkombëtare: një marrëveshje bërthamore me Iranin. Pothuajse çdo objektiv tjetër i politikës së jashtme kaloi në plan të dytë përballë atyre negociatave dhe ruajtja e koalicionit ndërkombëtar që i mbështeste ishte thelbësore."

Steinbaum pohon se si kundërvlerë për bashkëpunim rreth marrëveshjes së madhe me Iranin, "shumë besojnë se Rusia, dhe ndoshta edhe disa interesa evropiane, i kërkuan Shteteve të Bashkuara - partnerit kryesor të Kosovës - të ushtronin presion mbi shtetin e ri për të krijuar një gjykatë që do të hetonte dhe ndiqte penalisht këto akuza".

Nga këndvështrimi i presidentit Obama, një gjykatë e Kosovës e përbërë nga gjyqtarë ndërkombëtarë dhe e përkushtuar, të paktën në dukje, ndaj standardeve më të larta ligjore, ka të ngjarë t'i përshtatej formimit të tij juridik dhe ndjenjës së tij për drejtësi. Për të, kjo ishte një lëshim i lehtë. Udhëzimi zbriti deri tek Ambasada Amerikane në Prishtinë dhe në të gjithë Departamentin e Shtetit: Kosova duhej ta kryente këtë."

Pra, arsyeja se pse Shtetet e Bashkuara kërkuan krijimin e Dhomave të Specializuara, sipas Steinbaum, ishte "jo kryesisht për ta çuar përpara drejtësinë apo llogaridhënien për trafikimin e organeve ose krime të tjera të pretenduara të UÇK-së, por për t'i shërbyer një objektivi krejt tjetër: sigurimit të marrëveshjes bërthamore me

→

Iranin".
Steinbaum shpjegon tutje se "papritur diplomatët amerikanë në Prishtinë morën udhëzime të reja: t'i bëjnë presion Qeverisë së Kosovës që ta krijojë Gjykatën dhe të mos pranojnë "jo" si përgjigje. Zyrtarëve të lartë që vizitonin Kosovën u thuhej se vendi duhej të vepronte, përndryshe do të përballej me pasoja të rënda. Këtë e përjetova vetë gjatë një vizite me kongresistin Engel, për të cilin kam punuar për 27 vjet. Ambasadorja Tracey Jacobson na befasoi jo vetëm me ndryshimin e menjëhershëm të politikës amerikane, por edhe me urgjencën që qeveria amerikane i kushtonte krijimit të Gjykatës".
Jason Steinbaum, i cili ishte ndër zyrtarët më me përvojë në Ballkan në tërë Kongesin amerikan, tha që kongresmeni Engel u pendua për presionin e bërë ndaj Kosovës: "Si shumë të tjerë, edhe ne më vonë u penduam për qëndrimin që morëm dhe për rrëmujën e trishtueshme e shpërdoruese në të cilën është shndërruar Gjykata".
Steinbaum tutje konkludon se "Gjykata nuk u krijua vetëm për arsyen e gabuar. Ajo u krijua edhe në mënyrën e gabuar, mbi bazën e një ligji thellësisht të mangët". Pas shpjegimeve se si ekspertët amerikanë e zhveshën pjesëmarrjen e Kosovës në draftim të statutit dhe themelim, ai shpreh indinjatë të thellë se si prioritetet e Gjykatës Speciale janë krejtësisht të përmbysura: "Duke pasur parasysh krimet e rënda të kryera kundër shqiptarëve të Kosovës, krijimi i një gjykate për të gjykuar dhe ndëshkuar udhëheqësit e tyre të kohës së luftës dukej i përmbysur. Në fakt, Dhomat e Specializuara të Kosovës mund të jenë unike: një gjykatë e krijuar për t'i ndjekur penalisht viktimat dhe fitimtarët e një lufte, në vend të autorëve kryesorë dhe agresorëve të mundur".
Steinbaum analizon thellësisht edhe ndryshimin e çuditshëm të mandatit të proklamuar fillimisht: "Mandati i Gjykatës bëhet edhe më i çuditshëm kur krahasohet me qëllimin e saj fillestar. Ajo u krijua për t'i hetuar pretendimet e raportit të Martyt, i cili përqendrohej kryesisht në trafikimin e organeve. Megjithatë, aktakuzat nuk përmendin fare trafikimin e organeve. Në vend të kësaj, ato fokusohen në përgjegjësinë komanduese për sulme hakmarrëse të kryera nga aktorë të niveleve më të ulëta. Me fjalë të tjera, arsyeja kryesore për të cilën u krijua Gjykata nuk është më ajo që udhëheq procedurat e saj".

SHKRIMI ORIGJINAL I JASON STEINBAUM NË PORTALIN "BRIDGES OF MEMORY":

THE KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS - A CHRONICLE OF FAILURE

Jason Steinbaum, former staff director of the House Foreign Affairs Committee and adjunct professor at American University in Washington, D.C., argues that the KSC failed both Kosovo and justice.

Bridges of Memory
Jul 06, 2026
The Kosovo Specialist Chambers, also known as "the Special Court," was created for the wrong reason, in the wrong way, under the wrong law, and with the wrong mandate. Other than that, Mrs. Lincoln, how was the show?
That, in short, is why the Court has failed.
Before the Court was established, the U.S. government consistently downplayed allegations against the Kosovo Liberation Army (KLA), the rebel group that fought for Kosovo's independence during the 1998–1999 war. U.S. officials generally acknowledged that no army is perfect, especially in the fog of war, but maintained that the KLA had, on the whole, conducted itself reasonably. Some of the most serious accusations -- including claims that the KLA had engaged in terrorism or drug trafficking -- had already been publicly dismissed in a CIA report responding to an amendment by Rep. Eliot L. Engel, a strong supporter of Kosovo who later became Chair of the House Foreign Affairs Committee.
A few years later, a new round of allegations emerged from Swiss parliamentarian Dick Marty. Marty claimed that the KLA had engaged in organ trafficking, largely in Albania. Doubts increasingly arose because Marty offered little evidence to support his assertions. Nevertheless, in January 2011, the Council of Europe adopted Marty's report essentially verbatim, giving the call for an investigation the imprimatur of a major European institution.
For several years, the State Department gave Marty's claims little, if any, credence, even after the Council of Europe resolution. Then, almost overnight, the U.S. changed its position. American diplomats went from brushing aside Marty's report to insisting in 2015 that an international court was needed to investigate its allegations. Kosovo, they argued, would benefit by endorsing a legal process that would place the new country firmly on the side of justice and accountability.
But the hammer was sitting just behind the door. If Kosovo did not create the Court, U.S. diplomats warned, it would be created by the UN Security Council -- though, of course, it could not happen if the U.S. used its veto. More importantly, Kosovo was told it should act without delay because the United States, its strongest and most consistent ally, was asking -- read: demanding -- that it do so.
Naturally, a superpower like the United States has many global interests, and sometimes those interests collide. While the Marty allegations were simmering in Europe and being largely

→

ignored by Washington, the Obama Administration was pursuing its top international priority: a nuclear agreement with Iran. Nearly every foreign policy objective took a back seat to those negotiations, and maintaining the international coalition behind them was essential. That group, known as the P5+1, included the five permanent members of the UN Security Council plus Germany.

As a member of the P5+1, Russia had substantial leverage over the United States, given the importance President Obama placed on keeping the Iran coalition intact. If Russia or another partner requested a diplomatic move, it received serious attention. That is where the Specialist Chambers comes in.

There is no public record showing that Russia, or any European country, threatened to leave the P5+1 because of the Marty report. Still, many believe Russia, and possibly some European interests, urged the United States -- Kosovo's senior partner -- to pressure the young country into creating a court to investigate and prosecute the allegations.

From President Obama's perspective, a Kosovo court staffed by international judges and ostensibly committed to the highest legal standards likely appealed to his legal training and sense of fairness. For him, it was an easy concession. The instruction went down to the U.S. Embassy in Prishtina and throughout the State Department: Kosovo had to get this done.

So why did the United States demand the creation of the Specialist Chambers? Not primarily to advance justice or accountability for organ trafficking or other crimes by the KLA, but to serve the unrelated goal of securing the Iran nuclear deal.

Suddenly, American diplomats in Prishtina had new instructions: press the Kosovo government to create the Court and do not take no for an answer. Visiting dignitaries were told that Kosovo had to act or face a parade of horribles. I experienced this firsthand during a visit with Congressman Engel, for whom I worked for 27 years. Ambassador Tracey Jacobson surprised us not only with the sharp shift in U.S. policy, but also with the urgency the American government attached to establishing the Court. She strongly pressed Congressman Engel to urge the Kosovo government to pass the necessary law.

Reluctantly, and without knowing the reasons behind the policy change, Rep. Engel conveyed to Hashim Thaçi that the United States very much wanted Kosovo to establish the Court. Engel added that for Kosovo to move forward and be successful -- meaning maintaining US support -- it seemed necessary and important to create the Court. Like others, we came to regret the position we took and the sad and wasteful mess that the Court has become.

But the Court was not only created for the wrong reason. It was created in the wrong way, under a deeply flawed law.

American demands were expressed not only through diplomatic pressure. U.S. legal experts also had a heavy hand in drafting the constitutional and legal provisions needed to establish the Court. The result was a body made part of Kosovo's judicial system, but in name only. Not one Kosovar judge sits on this Kosovo court, and the Court itself resides not in Kosovo, but in The Hague. Under the laws the United States pressured Kosovo's Assembly to adopt, all meaningful authority over Kosovo's own Court was stripped from Kosovo's government. This framework left Kosovo with no real ownership of what is only nominally its own Court. The people of Kosovo have virtually no attachment to this coercively created judicial body, leaving it with little, if any, popular legitimacy. After telling the people of Kosovo for years that they are sovereign, taking such important proceedings out of their hands only diminishes that message.

Then there is the mandate.

It is axiomatic that anyone who commits war crimes should be prosecuted and tried. Period. That is true for Serbs, Kosovars, and everyone else.

But the mandate of this Court is deeply problematic. According to Human Rights Watch, "the overwhelming majority of war crimes in Kosovo were committed by Serbian and Yugoslav forces, for which no one has been held to account, including the organised transfer of hundreds of bodies to Serbia, where they were dumped in mass graves." Human Rights Watch further reported that "rape was used as an instrument of war in Kosovo, and it should be punished as such. The men who committed these terrible crimes must be brought to justice."

Given the grave crimes committed against Kosovo Albanians, creating a court to try and punish their wartime leaders seemed perverse. Indeed, the Kosovo Specialist Chambers may be unique: a court created to prosecute the victims and victors of a war, rather than the principal perpetrators and defeated aggressors. Kosovo Albanians feel this contradiction viscerally. Some have told me they believe the United States turned its back on them for reasons they still cannot understand.

They see former leaders sitting in jail for years without convictions. Among the defendants are Hashim Thaçi, a former president and prime minister, and Kadri Veseli, a former speaker of parliament. These are prominent individuals who voluntarily turned themselves in when indicted. They are not flight risks, and they remain innocent until proven guilty. Basic principles of international law support their freedom while investigations and trials proceed. If witnesses must be protected, there are ways to do so without imprisoning people who have not been convicted of a crime.

The Court's mandate becomes even stranger when measured against its original purpose. It was created to investigate the allegations in the Marty report, which focused largely on organ trafficking. Yet the indictments do not even mention organ trafficking. Instead, they focus on leadership culpability for retaliatory attacks by low-level actors. In other words, the central reason the Court was created no longer drives the proceedings.

It is long past time to bring justice to the victims of the Kosovo war. Hundreds of thousands were driven from their homes. Many thousands were murdered. Thousands more were raped. Justice will come when the perpetrators of those crimes are held accountable.

We know the vast majority of those crimes were committed by Serbian security forces. They are principally the ones who should be on trial.

Does that mean Kosovars who committed crimes should escape accountability? No. But if Kosovars are the only ones held accountable, something is seriously wrong with the system. Until that imbalance is corrected, the Kosovo Specialist Chambers will bring little peace, little trust between communities, and little long-term reconciliation in Kosovo or the wider region.

• Jason Steinbaum is Adjunct Professor of Government at The American University in Washington, DC. He is a member of the Board of Trustees of Rochester Institute of Technology Kosovo and a Peace Fellow at the Public International Law and Policy Group. He served in Congress for more than 30 years as Staff Director of the Foreign Affairs Committee of the House of Representatives and Washington Chief of Staff for Rep. Eliot L. Engel (D-NY).

• This editorial was published based on interview questions by Petrit Selimi, editor of the "Bridges of Memory" newsletter and former Foreign Minister of the Republic of Kosovo.

Linku i shkrimit anglisht: https://bridgesofmemory.substack.com/p/the-kosovo-specialist-chambers-a

* Shprehja "Other than that, Mrs. Lincoln, how was the show?" është një referencë ironike ndaj një batute të famshme amerikane. Emri Lincoln nuk ka lidhje direkte me Kosovën; është thjesht një shprehje idiomatike amerikane e përdorur për të ironizuar një situatë ku problemet janë aq të mëdha sa çdo koment tjetër bëhet absurd. Origjina: Pas vrasjes së presidentit Abraham Lincoln në teatër (1865), gruaja e tij, Mary Todd Lincoln, ishte e pranishme. Më vonë, në kulturën amerikane u krijua një shaka e hidhur: "Other than that, Mrs. Lincoln, how was the play?" - pra, përveç faktit që burri u vra, si ishte shfaqja? Kjo përdoret si figurë retorike për të theksuar absurditetin e minimizimit të një ngjarjeje katastrofike duke e trajtuar sikur është detaj i vogël. Autori thotë se Dhomat e Specializuara të Kosovës janë krijuar "për arsye të gabuara, në mënyrë të gabuar, me ligj të gabuar, me mandat të gabuar". Pastaj shton ironikisht: "Other than that, Mrs. Lincoln, how was the show?" Pra, është një mënyrë për të thënë: "Përveç gjithë këtyre dështimeve themelore, si ishte përvoja?" - duke nënkuptuar se nuk ka asgjë pozitive për t'u thënë.

GAFA, SHPËRTHIME DHE DEKLARATA TË TEPRUARA. DONALD TRUMP, MES NARCIZMIT DHE HUMBJES SË KONTROLLIT

Edhe ekspertët shprehen hapur: Donald Trump po shfaq "narcizëm dhe humbje kontrolli". Gjuha e drejtpërdrejtë që ishte forca e tij, tani është bërë kundërproduktive

NEW YORK – Nuk ishte vetëm përplasja me Papa Leonin, nga e cila doli i dëmtuar rëndë: prej Donald Trumpit, gjatë muajve dhe javëve të fundit, kemi parë një seri mbresëlënëse daljesh vetëshkatërruese në planin e komunikimit. Bëhet fjalë për një humbje progresive të kontaktit emocional me opinionin publik, që pati kulmin e saj më të qartë gjatë incidenteve të ICE në Minneapolis. Më pas, gjërat vetëm janë përkeqësuar.

Sot shqetëson mbi të gjitha mungesa e frenave në deklaratat e tij, gjithnjë e më ekstreme dhe hiperbolike, mania e madhështisë dhe prirja për t'u përplasur me këdo, shpesh me vulgaritet të papranueshëm. Fraza si "do t'i kthejmë ata bijtë e k… në epokën e gurit", referuar iranianëve, janë vetëm një shembull i një problemi presidencial që po merr konture patologjike dhe që nuk funksionon më: ajo gjuhë e drejtpërdrejtë dhe agresive, që për vite me radhë ishte forca e tij komunikuese, sot duket e konsumuar dhe kundërproduktive.

Problemi është se ai nuk e kupton që ka një qëndrim vetëshkatërrues. Këtë e konfirmojnë edhe sondazhet, me norma miratimi rreth 40% dhe madje 34% në një rast, shifra të paprecedenta për një president në prag të zgjedhjeve të mesmandatit, që nuk premtojnë mirë dhe krijojnë një spirale negative në sjelljen e tij. Në një sondazh të Reuters, 60% e të anketuarve vënë në dyshim qartësinë mendore dhe aftësinë e Trump për të qenë president, për shkak të moshës.

Megalomania e Donald Trump

Kjo nuk është një dinamikë e re. Shenjat e padurimit vërehen jo vetëm në marrëdhëniet politike, por pothuajse në çdo nismë të presidentit. Që nga transformimi i njëanshëm i hapësirave historike të Shtëpisë së Bardhë, deri te ideja për një hark monumental gjigant për të festuar 250-vjetorin e pavarësisë, apo njoftimi për një dollar argjendi me portretin e tij (i ndaluar për një president në detyrë), si dhe shtimi i firmës së tij në kartëmonedha, të gjitha këto janë gjëra të diskutueshme në shije dhe tregojnë një personalizim në rritje të pushtetit, për më tepër të paprecedentë.

Tipari dallues mbetet rrëfimi i suksesit individual: bindja se mund të veprojë i vetëm, mbi çdo ndërmjetësim. Në këtë kuptim, edhe ideja e harkut monumental është domethënëse.

Dorëzimi i projektit përmes një konkursi mes arkitektëve të mëdhenj, si Richard Meier, Peter Eisenman apo Frank Gehry, mund të ishte kthyer në një simbol bashkëkohor të përbashkët. Por në versionin aktual jemi larg një interpretimi kulturor modern, për një arsye të thjeshtë: jo vetëm që kjo lloj qasjeje nuk i përket atij, por do të ishte bërë "monumenti i tyre", i arkitektëve dhe amerikanëve, jo i tij.

Ekziston edhe një devijim institucional: mjafton të kujtojmë sulmet ndaj kreut të Rezervës Federale, Jerome Powell, të rrëzuara nga gjykatat, si dhe humbjen e fundit në gjykatë kundër Wall Street Journal dhe Murdoch, të cilit i kërkonte 10 miliardë dollarë për fyerje. Prirja për konflikt nuk e ndihmon më. Dhe pas përplasjes me Papa Leonin, ai publikon një imazh të vetes si Jezusi që shëron të sëmurët, sikur të mund të fitonte në rrjetet sociale duke u shpallur Zot.

Fatkeqësisht, imazhi qesharak në vetvete, nuk u pëlqye jo vetëm nga katolikët, por edhe nga komunitete të tjera të krishtera.

Debati klinik

Kritikat nuk vijnë më vetëm nga opozita. Zëra autoritarë brenda vetë lëvizjes MAGA e kanë sulmuar Donald Trump. Përplasja me Leonin solli një reagim të bashkuar nga Kisha katolike amerikane, me ndërhyrje publike të ipeshkvijve dhe kardinalëve, të cilët i cilësuan të papërshtatshme tonet dhe përmbajtjen, duke theksuar distancën mes rolit institucional dhe mënyrës së sjelljes së presidentit.

Paralelisht, debati është zgjeruar edhe në planin klinik. Figura me ndikim si John Gartner, psikolog klinik dhe ish-profesor në Johns Hopkins, i atribuojnë Donald Trump "narcizëm malinj" dhe shpjegojnë se kemi të bëjmë me një konfigurim personaliteti destruktiv, më shumë sesa një çrregullim të thjeshtë klinik. Të tjerë theksojnë nevojën për të shmangur diagnozat nga distanca.

Megjithatë, mbetet një perceptim i përhapur për një shkëputje në sjelljen presidenciale, e dukshme edhe në komunikim, shpesh i fragmentuar dhe i përsëritur, me vështirësi për të ruajtur një linjë të qëndrueshme në kohë. A kishte nevojë të sulmonte Giorgia Melonin, e cila i kishte treguar miqësi? Sigurisht që jo, por edhe këtu del në pah një qëndrim vetëshkatërrues.

Shtëpia e Bardhë i hedh poshtë këto interpretime, duke pretenduar se paparashikueshmëria është një strategji e qëllimshme. Por zhvillimet e fundit kanë rihapur pyetje më të gjera mbi aftësinë e lidershipit në një kontekst ndërkombëtar të paqëndrueshëm, ku koherenca dhe besueshmëria janë thelbësore. Siç shkroi New York Times, "shpërthimet e presidentit kanë ngritur pikëpyetje mbi lidershipin amerikan në kohë lufte".

Dhe si përgjigjet Donald Trump? Duke e çuar gjithmonë më tej përplasjen, me një stil që favorizon konfrontimin e drejtpërdrejtë dhe polarizimin. Toni nuk ndryshon dhe nuk tërhiqet: duke folur për ish-aleatët e tij si Tucker Carlson apo të tjerë që e kanë kritikuar, ai përdor receta të thjeshta: "Janë njerëz budallenj, e dinë vetë, e dinë familjet e tyre dhe e dinë të gjithë!… Janë të çmendur, nxitës trazirash dhe do të thonë çdo gjë për pak publicitet të lirë".

Fatkeqësisht për të, përballë nuk ka vetëm rezistencë gjithnjë e më të madhe, por edhe një amerikan tjetër, Papa Leoni, i cili papritur e ka bërë të duket më i vogël.

Por për të nuk ka problem: do t'i mohojë të gjitha. Edhe fjalën e Zotit. Dhe në mendjen e tij, njerëzit bëjnë mirë ta dëgjojnë.

/ Corriere della Sera – Bota.al

Sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Arjanit Fazlija i bashkohet Prishtinës

Prishtinë, 7 korrik - FC Prishtina ka vazhduar kompletimin e skuadrës për sezonin e ri, duke paraqitur afrimin më të ri, mesfushorin Arjanit Fazlija.
Fazlija vjen pas një rrugëtimi në futbollin gjerman, ku së fundmi ka qenë pjesë e SpVgg Greuther Furth. "Prishtina vazhdon kompletimin e skuadrës për sezonin e ri. Arjanit Fazlija është afrimi më i ri i bardhekaltërve. Mesfushori 21-vjeçar vjen pas një rruge zhvillimi në futbollin gjerman. Së fundmi ishte pjesë e Greuther Fürth, ndërsa më parë ka luajtur edhe për ekipin U19 të Bayer 04 Leverkusen. Hapat e parë në futboll i ka bërë në akademinë e FC Viktoria Köln. Fazlija ka qenë gjithashtu pjesë e të gjitha grupmoshave të Kosovës, duke veshur fanellën e përfaqësueseve U15, U17, U19 dhe U21", ka njoftuar FC Prishtina.

RONALDO LË TË HAPUR MUNDËSINË PËR TË LUAJTUR NË "EURO 2028"

Dallas, 7 korrik - Cristiano Ronaldo ka konfirmuar se Kupa e Botës 2026 ishte e fundit në karrierën e tij, por nuk e ka përjashtuar mundësinë të vazhdojë të luajë për përfaqësuesen e Portugalisë.
Sulmuesi portugez ka reaguar pas eliminimit të Portugalisë nga Spanja në fazën e 1/8-s së finales, ku një gol i shënuar në minutat shtesë ua ka siguruar spanjollëve kualifikimin. Ronaldo ka pranuar se është i zhgënjyer me mënyrën se si përfundoi rrugëtimi i tij në Kupën e Botës, por ka thënë se largohet me ndërgjegje të pastër. "Jam i trishtuar që u eliminuam nga Kupa e Botës në këtë mënyrë, por dhashë gjithçka. Dhurova më të mirën time dhe largohem me ndërgjegje të pastër. Ky është futbolli, kjo është jeta e një futbollisti. Ndonjëherë fiton, ndonjëherë humbet dhe duhet të vazhdosh përpara. E vërteta është se ky ishte Botërori im i fundit, po. Por tani do të kem kohë të mendoj, të jem me familjen time dhe të mos marr vendime me kokë të nxehtë. Jeta vazhdon", ka thënë Ronaldo.
Megjithatë, 41-vjeçari nuk e ka mbyllur derën për një vazhdim të karrierës me Portugalinë, duke lënë të kuptohet se mund të synojë pjesëmarrjen në Kampionatin Evropian të vitit 2028. Ai ka kujtuar edhe triumfin historik në "Euro 2016", të cilin e konsideron arritjen më të madhe me fanellën e Portugalisë. "Si ndihem sot? Njësoj. Me ndërgjegje të pastër. Dhurova më të mirën time. Kam fituar tre trofe me Portugalinë. Para Cristianos, Portugalia nuk kishte fituar asnjë trofe. Prandaj jam i lumtur. E vërteta është se trofeu më i madh që kam fituar me kombëtaren ishte ai i vitit 2016, i cili për mua ka të njëjtën vlerë si një Kupë Bote. Prandaj e përsëris, largohem me ndërgjegje të pastër. Dhashë gjithçka dhe kaq. Nesër është një ditë e re dhe jeta vazhdon", ka përfunduar ai. Ndryshe, Ronaldo është vetëm 24 gola larg për t'u bërë futbollisti i parë në histori që arrin shifrën e një mijë golave në karrierë.

FEDERATA FRANCEZE NGRE PADI NDAJ SENATORES PARAGUAJANE PËR KOMENTET RACISTE NDAJ MBAPPES

Paris, 7 korrik - Federata Franceze e Futbollit (FFF) ka konfirmuar zyrtarisht se do të ndërmarrë veprime ligjore ndaj senatores paraguajane Celeste Amarilla, pas deklaratave me përmbajtje raciste ndaj Kylian Mbappes, të bëra pas ndeshjes Francë - Paraguai në Kupën e Botës 2026.
Në deklaratën e saj, FFF-ja ka dënuar ashpër gjuhën e përdorur nga Amarilla, duke e cilësuar atë të papranueshme dhe të dënueshme. "Komentet raciste të senatores paraguajane Celeste Amarilla ndaj Kylian Mbappes janë jashtëzakonisht të neveritshme dhe të papranueshme. Si mund të shqiptohen fjalë të tilla? Këto deklarata janë kriminale dhe të dënueshme. Ato duhet të ndiqen penalisht, këtu dhe kudo. Federata Franceze e Futbollit do të paraqesë kallëzim pranë Prokurorisë për nisjen e procedurave gjyqësore", është thënë në reagimin zyrtar të FFF-së.
Senatorja Amarilla ka bërë një sërë deklaratash fyese dhe raciste ndaj sulmuesit francez. "Ky brutal nuk mësoi kurrë as të shkruajë. Në vend të qumështit të nënës, ai u ushqye me kokos dhe qeniet më të arsimuara që ka dëgjuar ndonjëherë kanë qenë shimpanzetë", ka thënë senatorja. Ajo ka shkuar edhe më tutje, duke thënë se lojtarët e përfaqësueses së Paraguait duhej ta kishin sulmuar Mbappen pas përfundimit të ndeshjes. "E vetmja gjë për të cilën shumë prej nesh pendohen është se La Albirroja nuk i dha një shuplakë të fortë në fytyrë në fund të ndeshjes. Dhe unë as nuk jam tifoze e futbollit", ka thënë Amarilla.
Ndërkohë, edhe vetë Kylian Mbappe ka reaguar ndaj deklaratave të senatores, duke e dënuar ashpër gjuhën e përdorur dhe duke e cilësuar të papranueshme sjelljen e një zyrtareje publike.

MANCHESTER CITY SYNON GODITJEN E MADHE, PËRGATIT OFERTË PREJ 150 MILIONË EUROSH PËR VINICIUSIN

Manchester, 7 korrik - Manchester City po përgatitet të bëjë një nga transferimet më të bujshme të afatit kalimtar të verës, duke synuar afrimin e yllit brazilian të Real Madridit, Vinicius Jr. Sipas raportimeve, klubi anglez është gati të paraqesë një ofertë prej 150 milionë eurosh për sulmuesin 25-vjeçar, duke synuar të përfitojë nga situata e paqartë rreth kontratës së tij me klubin madrilen.
Vinicius ka kontratë me Real Madridin deri në verën e vitit 2027, por ende nuk ka arritur marrëveshje për rinovimin e saj. Kjo nënkupton se braziliani do të hyjë në dy vitet e fundit të kontratës pa një akord të ri, duke shtuar pasigurinë rreth të ardhmes së tij në "Santiago Bernabeu".
Presidenti i Real Madridit, Florentino Perez, dëshiron ta blindojë sa më shpejt lojtarin, por negociatat thuhet se kanë ngecur për shkak të kërkesave financiare të sulmuesit.
Vinicius kërkon një pagë neto prej rreth 30 milionë eurosh në sezon për të firmosur kontratën e re, një shifër që drejtuesit e Real Madridit nuk janë të gatshëm ta pranojnë.
Pas dy sezoneve radhazi pa fituar titullin e Ligës Premiere, drejtuesit e Manchester Cityt besojnë se skuadra ka nevojë për

një tjetër yll botëror për ta rikthyer dominimin në Angli dhe Evropë.
Trajneri Enzo Maresca, i cili ka marrë drejtimin e ekipit pas largimit të Pep Guardiolës, e konsideron Viniciusin përforcimin ideal për repartin ofensiv.
Në projektin e tij, braziliani do të formonte një treshe spektakolare së bashku me talentin francez Rayan Cherki dhe sulmuesin norvegjez Erling Haaland, duke krijuar një nga repartet sulmuese më të frikshme në futbollin evropian.
Një tjetër faktor që mund të ndikojë në vendimin e brazilianit është ardhja e Kylian Mbappes te Real Madridi. Me transferimin e francezit, Vinicius nuk konsiderohet më figura kryesore e projektit sportiv të klubit, ndërsa raportet sugjerojnë se ai nuk është plotësisht i kënaqur me rolin e ri brenda skuadrës.
Në Manchester City braziliani do të kishte mundësinë të ishte sërish lideri kryesor i projektit, me lojën sulmuese të ndërtuar rreth shpejtësisë, driblimit dhe aftësive të tij krijuese. Sezonin e kaluar Vinicius ka zhvilluar një tjetër edicion të shkëlqyer me fanellën e Real Madridit, duke regjistruar 22 gola dhe 14 asistime në 53 paraqitje në të gjitha garat. Këto statistika e konfirmojnë brazilianin si një nga sulmuesit më të mirë në botë dhe një objektiv për çdo klub elitar.
Mbetet të shihet nëse Manchester City do ta konkretizojë ofertën prej 150 milionë eurosh dhe nëse Real Madridi do të jetë i gatshëm të negociojë largimin e një prej yjeve më të mëdhenj.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës: Personel i Sigurisë Fizike (3 pozita)
Grada e pozitës: D13
Kohëzgjatja e punësimit: me afat të pacaktuar
Divizioni: Siguria Fizike
I raporton: Udhëheqësit të Divizionit të Sigurisë Fizike

BQK inkurajon të gjithë të interesuarit që të aplikojnë për këto pozita pavarësisht gjinisë!

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të jetë vigjilent në mbrojtjen e pasurisë dhe personelit të BQK-s gjatë tërë kohës në detyrë;
- Të jetë i kujdesshëm dhe të ketë vetiniciativë në organizimin e pengimit të çfarëdo rreziku që mund t'i kanoset objektit dhe personelit të BQK-s;
- Të raportojë menjëherë për rastet të cilat paraqesin rrezik eventual ose tentimet e veprimeve të pa autorizuara të futjes në objekt etj. duke bashkëpunuar me Policinë e Kosovës;
- Të sigurojë që kushtet dhe rrethanat e sigurisë nuk rrezikojnë personelin e BQK-së, dhe duke respektuar rregullat intervenon në çdo situatë ku punëtori ose vizitori pëson ndonjë aksident, lëndim ose ndonjë humbje të gjësendeve të tyre;
- Të jetë në gjendje t'i kuptojë dhe t'i shfrytëzojë të gjitha pajisjet elektronike të sigurisë, si: sistemin e vëzhgimit me kamera, alarmet, etj. dhe të sigurojë të gjitha hapësirat brenda dhe jashtë objektit;
- Të sigurojë që evidencat për çfarëdo rasti apo incidenti të mbesin të paprekura deri të arrijnë autoritetet për hulumtimin e tyre;
- Të kontrollojë në mënyrë të vazhdueshme funksionimin e pajisjeve elektronike të cilat shërbejnë për sigurinë – të raportojë menjëherë tek udhëheqësi i DSF-së për çdo parregullsi të vërejtur;
- Ta kuptojë Politikën e Sigurisë Fizike të BQK-së, vendimet ekzekutive dhe urdhëresat administrative lidhur me sigurinë fizike, dhe t'iu përmbahet me përpikëri atyre;
- T'i përmbahet me përpikëri rregullores rreth punëve të përditshme të njësisë së sigurisë fizike;
- Të zbatojë të gjitha kërkesat lidhur me sigurinë të dhëna nga Udhëheqësi i Divizionit të Sigurimit dhe Bordi Ekzekutiv i BQK-s.

Edukimi dhe kualifikimi:

- Shkollim i mesëm i lartë sipas legjislacionit në fuqi;
- Certifikimet nga organet e sigurisë apo mbrojtjes konsiderohen përparësi;
- Shkathtësi të mira komunikimi;
- Njohuria për përdorimin e kompjuterit është përparësi.

Përvoja e punës:

- Së paku 3 vite përvojë në fushën e sigurisë fizike;

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Aplikimet me mosplotësim të plotë dhe korrekt të **Formularit zyrtar të BQK-së** gjatë aplikimit online nuk do të merren në shqyrtim dhe rezultojnë me diskualifikim gjatë procesit të përzgjedhjes.
- Kandidatët duhet të bashkëngjisin **letër përcjellëse (motivuese),** e cila duhet të jetë e adresuar dhe e përgatitur posaçërisht **për pozitën për të cilën aplikojnë**; në të kundërtën, aplikimi nuk do të merret në shqyrtim;
- **Dëshmi mbi përvojën e punës**, që **mbulojnë së paku tre (3) vite** përvojë pune (kopje të kontratave të punës, vërtetime nga punëdhënësi apo dokumente të tjera relevante që dëshmojnë pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale).
- **Raporti nga Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, që mbulon së paku tre (3) vite përvojë pune, ose, në rastet kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht, vërtetim tatimor nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK);
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **23 korrik 2026**.
- Aplikimi mund të bëhet online (https://hris.bqk-kos.org) përmes faqes zyrtare
- të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

OGLAS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Naziv radnog mesta: Radnik fizičkog obezbeđenja (3 radna mesta)
Stepen radnog mesta: D13
Trajanje zapošljavanja: na neodređeno vreme
Odsek: Fizičko obezbeđenje
Izveštava: Rukovodiocu Odseka za fizičko obezbeđenje

CBK ohrabruje sve zainteresovane da podnose prijave za ova radna mesta, bez obzira na pol!

Dužnosti i odgovornosti:

- Da bude oprezan u zaštiti imovine i osoblja CBK-a tokom celokupnog vremena na dužnosti;
- Da bude pažljiv i da pokazuje samoinicijativu u organizovanju sprečavanja bilo kakve opasnosti koja može pretiti objektu i osoblju CBK-a;
- Da odmah prijavljuje sve slučajeve koji predstavljaju eventualnu opasnost ili pokušaje neovlašćenih radnji ulaska u objekat itd. sarađujući sa Policijom Kosova;
- Da obezbedi da bezbednosni uslovi i okolnosti ne ugrožavaju osoblje CBK-a, i da, poštujući pravila, interveniše u svakoj situaciji u kojoj zaposleni ili posetilac doživi neku nesreću, povredu ili gubitak svojih stvari;
- Da bude u stanju da razume i koristi svu elektronsku bezbednosnu opremu, kao što su: sistem video-nadzora sa kamerama, alarmi, itd. i da obezbeđuje sve prostorije unutar i van objekta;
- Da obezbedi da dokazi za bilo koji slučaj ili incident ostanu netaknuti do dolaska nadležnih organa radi njihove istrage;
- Da stalno kontroliše funkcionisanje elektronske opreme koja služi za bezbednost – i da odmah izvesti rukovodioca OFB-a o svakoj uočenoj nepravilnosti;
- Da razume Politiku fizičkog obezbeđenja CBK-a, izvršne odluke i administrativne naredbe u vezi sa fizičkim obezbeđenjem, i da ih se striktno pridržava;
- Da se striktno pridržava uredbe o svakodnevnim poslovima jedinice za fizičko obezbeđenje;
- Da sprovodi sve zahteve u vezi sa bezbednošću koje nalažu Rukovodilac Odseka za obezbeđenje i Izvršni odbor CBK-a.

Obrazovanje i kvalifikacije:

- Više srednje obrazovanje u skladu sa važećim zakonodavstvom;
- Sertifikati od organa bezbednosti ili odbrane smatraju se prednošću;
- Dobre komunikacione veštine;
- Poznavanje rada na računaru smatra se prednošću.

Radno iskustvo:

- Najmanje 3 godine iskustva u oblasti fizičkog obezbeđenja;

Svi kandidati treba dostaviti sledeće dokumente:

- Prijave sa nepotpuno i netačno popunjenim **Zvaničnim obrascem CBK-a** tokom podnošenja prijave onlajn, neće se uzeti u razmatranje i rezultiraće diskvalifikacijom tokom procesa selekcije.
- Kandidati moraju priložiti **propratno (motivaciono) pismo,** koje mora biti adresirano i pripremljeno posebno **za radno mesto za koju podnose prijave;** u suprotnom, prijava se neće uzeti u razmatranje;
- **Dokaz o radnom iskustvu,** koji **pokriva najmanje tri (3) godine** radnog iskustva (kopije ugovora o radu, potvrde od poslodavca ili druge relevantne dokumente koji dokazuju radno mesto na kojem je radio i radno iskustvo, bez ugrožavanja relevantnih akata o zaštiti ličnih podataka).
- **Izveštaj iz Kosovskog penzijskog štednog fonda (Trusta)** za odgovarajući period, koji pokriva najmanje tri (3) godine radnog iskustva, ili, u slučajevima kada se izveštaj iz Trusta ne primenjuje zakonski, poreska potvrda od Poreske administracije Kosova (PAK);
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

Postupak podnošenja prijave:

- Zadnji rok za podnošenje prijave je **23. jul 2026. godine.**
- Podnošenje prijave može se vršiti onlajn (https://hris.bqk-kos.org) putem zvanične internet stranice CBK-a. Drugi oblici podnošenja prijave neće se uzeti u obzir.

Duke u bazuar në nenin 7 të Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI – Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në bashkëpunim me operatorin "Ev Wind Park" SH.P.K. Prishtinë, kërkesa me nr. prot. 26/3522/560/MMPH-DMM për t'u pajisur me Leje Mjedisore, për Parku i energjisë me erë (35 MW) Zatriçi 2 në Zatriç, Rahovec, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për kërkesën për t'u pajisur me Leje Mjedisore

Njoftohet publiku i interesuar se me datë: 27.07.2026, në ora: 09:30, në hapësirat e Administrative te Kompanisë në Zatriq, Komuna Rahovec, do të organizohet debat publik nga operatori "Ev Wind Park" SH.P.K. Prishtinë, kërkesa për t'u pajisur me Leje Mjedisore me nr. prot. 26/3522/560/MMPH-DMM, për Parku i energjisë me erë (35 MW) Zatriçi 2 në Zatriç, Rahovec, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM:

ID: 216 652 4738
Passcode: 123123
Zoom meeting link:
https://us05web.zoom.us/j/2166524738?pwd=aJtauckjGTWwqBViElFDw68NDo3rzD.1

Në linkun e mëposhtëm, mund të gjeni aplikacionin e publikuar në ueb faqe të MMPH-së, për komente të publikut:

https://mmphi.rks-gov.net/Document?search=MATR

Pjesëmarrja e publikut është e mirëseardhur dhe e rëndësishme për procesin.

Me respekt,
"EV Wind Park" Sh.p.

SH.P.K. "EV Wind Park" RAHOVEC

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Humana PK" SH.P.K. pronar Petrit Krasniqi me seli në Kamenicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812425173 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Humana PK" D.O.O. Petrit Krasniqi, Kamenica donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812425173 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Humana PK" L.L.C. with owner Petrit Krasniqi with headquarters Kamenica, has come to the decision to quit its business: 812425173 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Bio-Ramoci" SH.P.K. me seli në Gjakovë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 71323447 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Bio-Ramoci" D.O.O. Djakovica donelo odluku o prestani rada sa nrb. 71323447 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Bio-Ramoci" L.L.C. with headquarters Gjakovë, has come to the decision to quit its business: 71323447 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Vetula Morina shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. Mamush Prizren.

Florida Sada shpall të pavlefshme dëftesën e klases I, II, III, IV dhe diplomën e Gjimnazit "HAJDAR DUSHI", Gjakovë

Herolind Avdijaj B.I. shpall të humbur numrin Unik Identifikues 812184886 të lëshuar nga ARBK.

Artin Daka shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 11.12 të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

Gjin Biblekaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

Arianit Efendija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

Betim Idrizi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 12 të sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë

- Sali Voca shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të Lartë Teknike "Arkitekt Sinani" ish shkolla e mesme "Boris Kidric".

- Shemsi Zeneli B.I D.P.H. Koshare 1999 shpalle të pavlefshme certifikatën e biznesit me nui: 810203430.

- Adizo SH.P.K. me nr. 812421460 bënë zvogëlim të kapitalit lëshuar nga ARBK.
- Jetmir Morina shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e sh.m. profesionale "Gjon Nikoll Kazazi" Gjakovë.

- Vlora I. Gashi B.I. Rogovë shpall të humbur numrin unik identifikues 811865552 lëshuar nga ARBK

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

100%
Fresh &
Natural
VIDAS
Llatte
drink
2%
VIDAS
TAMËL
2,8%
VIDAS
Schmand
VIDAS
JOGURT
VIDAS
DHALLË

ROYAL CROWN
RC
cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L

MEKA
HALAL FOOD
TRADITË QË NGA
1992
MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË
PULE
GLUTEN FREE
100% MISH PULE
CILËSI E GARANTUAR
PA KONSERVUES